



Prishtinë, 28 janar 2019  
Kodi i ZRRE-së: V\_1103\_2019

**Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji,**

bazuar në:

- Dispozitat e Nenit 15 , dhe Dispozitat e Nenit 26 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Ligji Nr. 05/L-084);
- Dispozitat e Nenit 5.2 të Procedurës së Menaxhimit të Kodeve Teknike/Operacionale (KQKO); dhe
- Kërkesën e Operatorit të Sistemit të Transmisionit dhe Tregut (KOSTT Sh.A) për emërimin të Kryesuesit të KQKO-së të datës 26.12.2018,

në seancën e mbajtur me datë 28.01.2019, nxori këtë:

**VENDIM**

- I. **APROVOHET** kërkesa e KOSTT për emërimin e z. **Labinot Gashi - Kryesues i Komisionit Qeverisës të Kodeve Operacionale (KQKO).**

**Arsyetim**

- Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) me datë 26.12.2018 ka pranuar Kërkesën e Operatorit të Sistemit të Transmisionit dhe Tregut – KOSTT që z. Labinot Gashi të emërohet si Kryesues i ri i KQKO-së. Z. Labinot Gashi është i punësuar në KOSTT dhe mbanë pozitën *Specialist për Çështje Rregullative*, i cili disponon një përvojë të konsiderueshme në fushën e zbatimit të kodeve teknike. Z. Gashi gjithashtu ka mbajtur pozitën e Sekretarit të KQKO-së që nga muaji mars 2010.
  - Pas shqyrtimit të kërkesës së KOSTT, ZRRE konsideron se z. Labinot Gashi përmbush kërkesat për emërim në pozitën Kryesues i KQKO-së dhe me këtë vendim aprovon kërkesën e KOSTT për emërim në pozitën Kryesues i KQKO.
- II. Vendimi nxirret dhe publikohet në gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës.




III. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi i Zyrës së Rregullatorit dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

**Këshillë juridike:** Kundër këtij vendimi, pala e pakënaqur mund t'i drejtohet Gjykatës Kompetente brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të Vendimit në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.


Vendimi i dërgohet:


- Të licencuarit KOSTT Sh.A.
- Arkivit të Zyrës së Rregullatorit për Energji

**Bordi i ZRRE-së**

  
Arsim Janova, u.d. kryesuesit

  
Besim Sejfiqaj, anëtar

  
Selman Hoti, anëtar

  
Izet Rushiti, anëtar